



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:277675  
Datë: 16.12.2024  
Numri i dokumentit: 06606422

K.Dh.Sh.II.nr.2027/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Faton Bajrami dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP “Doqi” me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Fiskal, KF.nr.526/22 të datës 20.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Fiskal, KF.nr.526/22 të datës 20.06.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Fiskal, KF.nr.526/22 të datës 20.06.2024, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Doqi” N.T.SH me seli në Ferizaj. II. Anulohet aktvendimi me nr.01.3.2.2/18324 i datës 09.11.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë. III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Doqi” N.T.SH me seli në Ferizaj, t’ia kthej shumën prej 2,491.28 € (dymijë e katërqind e nëntëdhjetë e një euro e njëzet e tetë centë), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-23854/21.08.2021, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Ferizaj, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë 08.12.2021 e deri në pagesën e plotë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të LPK, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa në tërësi

si e bazuar në ligj, të priset aktgjykimi KF.nr.526/2022 i datës 20.06.2024 si i pa bazuar në ligj, të refuzohet padia dhe kërkesëpadija e paditësit në tërësi si e pabazuar në ligj dhe të mbetet në fuqi vendimi i kontestuar ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/18324 të datës 09.11.2021, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë N.T.P “Doqi” – Ferizaj, për rishqyrtimin e vendimit R-23854 të datës 21.08.2021 të ZBD Ferizaj.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar t vendimin e lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit NTP “Doqi”, me seli në Ferizaj t’ia kthej shumën prej 1,000.00€, të paguar më tepër, në emër të kundërvajtjes doganore, për shkak të kontestimit të paritetit të mallit në deklaratën Unike Doganore me nr.R-23845/21.08.2021, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Ferizaj, në afat prej 15 ditësh nga dit e pranimit të këtij aktgjykimi. Në arsyetimin e aktgjykimit kontestues është theksuar se Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi të të paditurës në vendimin e kontestuar, sipas të cilit pariteti i deklaruar CIF Selanik e i cili ka mbështetje në faturën nr.21CZLT0524, nuk është paritet real i paguar i mallit me qellim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se e paditura do të mund të mbështeste një konstatim të tillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit vetëm çmimin neto të faturës së mallit pa përfshirë edhe shpenzimet e transportit detar deri në Selanik/Greqi, ku vlera e mallit të faturuar me faturën nr. 21CZLT0524, nga eksportuesi është pranuar nga paditësi përmes Urdhërpagesave Ndërkombëtare me status aprovuar të datës 24.05.2021 dhe 13.07.2021, në emër të mallit me paritet CIF Selanik dhe të cilat pagesa janë në harmoni të plotë të kuptim të vlerës.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkëlqe qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkëlqe gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e

shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë provat e potencuar në përgjigjen në padi, por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerr konkluzion të gabuar duke aprovuar padinë e paditësit. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar se paditësi ka paraqitur faturën e mallit lëndor nr.21CZLT0524 nga eksportuesi e cila është paguar nga paditësi përmes Urdhërpagesave ndërkombëtare me status të aprovuar të datës: 24.05.2021 dhe 13.07.2021, në emër të faturës dhe e cila është në harmoni të plotë në kuptim të shumës si në faturë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Numri i lëndës: 2021:277675  
Datë: 16.12.2024  
Numri i dokumentit: 06606422

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.2027/24, me datë 16.12.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari  
Dren Rogova